



SINDIKATA E ENERGJISË (PRODHIM)


Lëvizja sindikaliste në sektorin e energjisë është shumë efektive. FSPISH ka qënë shumë kërkuese për sa i përket të drejtave dhe lirive sindikaliste të punonjësve anëtarë të FSPISH-s. Deri më tani kemi arritur sukses, ku të gjithë punonjësit, në kompani të ndryshme ku FSPISH ka kontrata kolektive, kanë benefite të pamohueshme, të fituara nga Kontrata Kolektive e Punës.

Gjithashtu i është dhënë rëndësi e veçantë rolit të gruas në FSPISH, ku çdo grua për 8- Mars, Dita Ndërkombëtare e Gruas, marrin një shpërblim ekstra nga Kompania. Kjo ka dhënë një rezultat shumë pozitiv në performancën dhe produktivitetin profesional të punonjëseve femra në Kompaninë KESH sh.a., por edhe në kompani të tjera ku FSPISH ka kontrata kolektive.

Me rinovimin e Kontratës Kolektive të re të Punës, pas negociatave me Administratorin e ri të Kompanisë KESH sh.a, u mundësuan përfitime të tjera, për sa i përket shpërblimit të punonjësve që dalin në pension, duke e shumëfishuar atë, sipas përfitimit që përcakton Kodi Punës së RSh, gjithashtu dhe ndihmë ekonomike për punonjësit që kryejnë ndërhyrje kirurgjikale dhe të tjera benefite për punonjësit.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua rasteve të aksidenteve në punë, ku sipas ligjit në fuqi, kompesohet nga shteti, por FSPISH kërkoi që t'u jepet një prioritet për punësim në KESH sh.a të familjarëve të personave të aksidentuar apo dhe atyre që dalin në pension, duke mundësuar kështu një mirëqenie ekonomike dhe sociale të familjarëve të tjerë.

FSPISH organizon punonjësit në sektorin e prodhimit të energjisë dhe punëtorët e HECEVE të Ulez-Shkopet dhe Bistrica1 dhe Bistrica 2. Kudo ku FSPISH ka kontrata kolektive, punonjësit janë të mbrojtur dhe përfitimet e kontratës kolektive shtrihen tek të gjithë punonjësit dhe janë të pamohueshme. Kjo ka bërë që Federata të jetë gjithmonë në rritje të anëtarësisë së saj.





SINDIKATA E ENERGJISË (SHPËRNDARJE)

Një punë e madhe dhe e papërshkruar është bërë në kompaninë OSHEE sh.a., ku punonjësit punonin duke mos marrë djersën e tyre, ishin të nëpërkëmbur dhe të gjunjëzuar përpara presioneve të ushtruar nga titullarë të papërgjegjshëm. Na u desh një punë prej shumë vitesh të hiqnim emrin e keq që në këtë kompani “ nuk punohet, por vidhet”.

Bashkëpunimi i Federatës me kompaninë në fillim ishte tejet i zbehtë dhe nuk kishin besim që sindikata të mundte të mbronte të drejtat e punonjësve. Gjatë kësaj periudhe u bënë shumë tentativa, mbledhje, organizime të disa takimeve të rëndësishme si në kompani, ashtu dhe në Ministrinë e Energjisë, duke shprehur në të gjitha këto takime shqetësimet që kishte Sindikata për mbarëvajtjen e punëve në këtë Kompani.

Në këtë periudhë, FSPISH në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë, me Këshillin Mbikqyrës të Kompanisë, si dhe me drejtuesit kryesorë të Kompanisë OSHEE sh.a., i propozuan qeverisë dhe Kryeministrit Rama për rritjen e pagave në këtë kompani, e cila që nga viti 90-të deri në atë dite, kishte pagat teje të ulta, duke nëpërkëmbur dinjitetin dhe punën e punonjësve, të cilet robëtoheshin në mënyrë barbare.

Në të 2016-ës, u bë e mundur realizimi i rritjes së pagave për të gjithë punonjësit e Kompanisë OSHEE, nga 37 % deri në 150%. Kjo rritje page është rritja më e madhe historike që është bërë deri më sot.

Kemi kërkuar me përpikmëri zbatimin e rregullave të sigurimit teknik si dhe rregulloren e brendshme të kompanisë. Të gjithë të zgjedhurit në krye të sindikatës në kompaninë OSHEE sh.a., kanë përballuar dhe kryer me sukses punën e tyre në organizimin dhe lëvizjen sindikale në kompani. Së bashku jemi të sigurtë, të mbrojtur dhe dinjitoz!

Sindikata në sektorin e shpërndarjes së energjisë, është një sindikatë që ka shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për vetë faktin që kompania OSHEE sh.a. është shpërndarësja kryesore në Republikën e Shqipërisë.

Kjo Sindikatë është dhe sindikata që shënon numrin më të madh të anëtarësisë.

Këto 5 vite mund të themi që kjo sindikatë ka bërë një hov të madh sindikalist.





SINDIKATA ENERGJISË (TRANSMETIM)

Sindikata në kompaninë OST është një sindikatë relativisht e sapo krijuar, por jemi të bindur dhe me shumë vullnet, që të mbrojmë të drejtat dhe interesat e punonjësve në këtë kompani.

Të gjithë të zgjedhurit në krye të kësaj sindikate janë shumë të përkushtuar në misionin e tyre.

Kjo ka bërë që FSPISH të ndjehet krenare për punën dhe përkushtimin për anëtarët e saj por jo vetëm.

Lidhja e Kontratës Kolektive mes kompanisë OST dhe FSPISH, bëri të mundur përfitimin e shumë benefiteve për punonjësit, gjithashtu dhe garantimin e zbatimit me përpikmëri dhe rigorozitet të çdo pike të shënuar dhe të dakordësuar në Kontratën Kolektive të punës, gjë që sipas punonjësve të OST-s, ka qënë vetëm një firmë në fund dhe asgjë më shumë.

Duke parë neglizhencën e treguar për sa i përket mbrojtjes së punonjësve, FSPISH u premtonte atyre që do jetë gjithmonë në krye të çdo thirrjeje për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre.

FSPISH

#MBROJTJE

#SIGURI

#DINJITET

SË BASHKU PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË!

SINDIKATA METALURGISJË



Në Sindikatën e metalurgjisë, FSPISH organizon punonjësit në disa kompani të ndryshme me pronarë të huaj dhe vendas. Ashtu sikurse dhe dihet, metalurgjia futet në profesionet e vështira, kështu që dhe trajtimi i punonjësve në këtë sektor duhet të jetë brenda disa kriterëve të mirpërcaktuara si me rregullore të brendshme të kompanisë, ashtu dhe me rregulla të ndryshme të përcaktuara nga Shteti Shqiptar.

Këto vite pune kanë qënë vite shumë të vështira dhe shumë sprovuese për kompanitë dhe njëkohësisht ku gjithçka binte në kurriz të punonjësve. Kështu vigjilenca dhe dialogu ishin mjetet më të domosdoshme për të parandaluar padrejtësitë me punonjësit. Gjithashtu puna e bërë nga kryetarët e Sindikatës në uzina të ndryshme, është për t'u admiruar.

Vështirësitë dhe sfidat që kanë prekur Kompanitë e ndryshme, deri në mundësinë e falimentimit, nuk arritën të prekin asnjë punonjës në këto uzina, por përkundrazi, është negociuar dhe rënë dakord mes Punëdhënësve dhe Punëmarrësve, duke rënë në konsensus të përbashkët, që punonjësit të vazhdonin të kishin punën e tyre për të mbajtur familjet. Vlen të theksohet, që puna e përkushtuar e punonjësve të këtyre uzinave, dhe njëkohësisht dhe motivimi i tillë dhe vlerësimi nga ana e punëdhënësve të dakordësuar, ka bërë të mundur ringritjen e punës dhe daljen nga falimentimi i tyre.

Një arritje e madhe është ngritja e pagave për të gjithë punonjësit e kompanisë "KURUM International" që operon në uzinën e Çelik-Petëzimit në Elbasan. Këtë vit me rinëshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës, u bë e mundur rritja e pagës sipas kriterëve të përcaktuara nga një studim për pagat në këtë sektor, i cili bazohet në kriterë bazë për matjen dhe përcaktimin e shkallës së vështirësisë dhe vlerësimin në bazë të këtyre kriterëve. Ne jemi në dialog që ky studim të jetë i vlefshëm dhe për kompanitë e tjera që operojnë në këtë sektor dhe FSPISH ka Kontrata Kolektive.



Tjetër çështje shumë delikate dhe koherente është dixhitalizimi dhe teknologjia në këto profesione të vështira. Ashtu sikurse industria 4.0 është prezente kudo, ne po përballemi me këtë fenomen në të gjithë sektorët tanë. Një tranzicion sa më i drejtë për të gjithë punonjësit, ka qënë dhe do të jetë motoja jonë për këtë çështje. Teknologjia të jetë në funksion të punonjësve, dhe jo të bëhet shkak i papunësisë së tyre. Vlerësimi i qënies njerëzore mbi gjithçka dhe çdo gjë.

SINDIKATA E MINIERAVE



FSPISH organizon punonjësit e minierës së Kromit, në Bulqizë, ku operon kompania "Albkrome". Kjo minierë është një nga minierat më bashkëkohore dhe njëkohësisht më e rregullta në Bulqizë, apo dhe në zona të tjera ku ka miniera të tilla.

Organizimi i FSPISH-s në këtë minierë ka vite dhe vlen të theksohet se në sajë të Sindikatës janë bërë ndryshime dhe përparime të mëdha në këtë minierë.

Sigurisht, ka dhe shumë për të bërë, ne s'do të ndalemi asnjëherë për të mbrojtur interesat e punonjësve, të cilët janë të vetmit që gjithmonë janë të prekur nga padrejtësitë.

I është dhënë vëmendja e duhur sigurisë dhe shëndetit në punë, masave dhe veshjeve të caktuara për në minierë, si dhe sigurimit të jetës së punonjësve, duke mëshuar kështu që siguria e jetës së tyre dhe kushteve të punës që ata punojnë të jetë primare në çdo aspekt.

Aksidente fatale, deri në humbjen e jetës, ndodhin herë pas here në minierat rreth e qark zonës së Bulqizës.



Kjo ka bërë që ne si FSPISH t'i bëjmë thirrje të gjithë punonjësve që punojnë në këto miniera "fantazmë", të organizohen dhe t'i thonë jo informalitetit dhe vetëm në këtë mënyrë do të kenë një punë të sigurtë, jeta e tyre nuk do të varet në fije të perit, pagat do të jenë dinjitoze dhe sigurisht fitimi nuk do të shkojë vetëm për xhepat e pronarëve.

Do të kemi një shpërndarje të drejtë të fitimit, ku do të bëjë të mundur rritje ekonomike dhe sociale për të gjithë zonat ku këto miniera janë, dhe jo vetëm.

SINDIKATA NAFTËS



FSPISH organizon punonjësit e uzinës së përpunimit të naftës në Ballsh, Fier. Kjo uzinë ka kaluar shumë peripeci deri më tani dhe çdo gjë ka rënë mbi punonjësit e kësaj uzine. Kompani të ndryshme vendase dhe të huaja, kanë qënë pjesë e këtij 'show' skandaloz i cili ka çuar në degradim të uzinës. Kemi kërkuar që këto kompani të japin llogari për padrejtësitë e tyre kundrejt punonjësve, por askush nuk ka bërë gjë deri më tani.

FSPISH ka hapur procese gjyqësore për të mbrojtur të drejtën dhe djersën e mohuar punonjësve të kësaj uzine. Nga FSPISH është mundësuar asistencë juridike për të gjitha rastet ku ka pasur shkelje apo padrejtësi për çdo punonjës dhe do të vazhdojmë gjyqet deri në një vendim pozitiv për punonjësit e uzinës. Është për t'u cilësuar se jemi në rrugën drejt përfundimit të gjyqit dhe gjithshka është në favor të punonjësve. Përpos këtyre gjyqeve të hapura për kompanitë e mëparshme, peripecitë akoma skanë të sosur për fatin e kësaj uzine dhe të punonjësve të saj. Kjo uzinë është një uzinë strategjike, ku një pjesë e saj është shtetërore. Por atëherë përse lihet në dorë të fatit? Kjo është një pyetje pa përgjigje, gjithsesi ne e dimë shumë mirë atë. Pjesë e manipulimit janë dhe politikanë të ndryshëm, që nuk kënaqen vetëm me rrogat marramendëse, por duan të fusin duart dhe tek i vetmi burim i jetesës për atë zonë, duke e çuar këtë uzinë drejt falimentimit.

Aktualisht në këtë uzinë, operon kompania "Byllis Energy" sh.a, e cila ka informuar që zyrat qëndrore i ka në Gjenevë. Pasi kjo Kompani e mori uzinën, filloi të bënte padrejtësi nga më të ndryshmet, deri në pushim nga puna të punonjësve që do të vazhdonin të ishin në Sindikatë. Punonjësit edhe pse të kërcënuar, i kanë qëndruar besnikë dhe të palëkundur anëtarësimi në FSPISH. Njëkohësisht drejtuesit e kësaj kompanie, nuk kanë lejuar kryetarët e sindikatës të futen në ambjentet e uzinës, dhe rrjedhimisht të mos e ushtrojnë aktivitetin e tyre sindikalist. FSPISH e ka ngritur këtë problem si në të gjitha instancat shtetërore, përkatëse për zgjidhjen e tyre, edhe në organizata sindikale ndërkombëtare ku është e afiliuar, si industriALL Europe e Global Union.

I janë dërguar letra zyrtare ku gjithmonë është treguar një indiferentizëm nga ana e punëdhënësit. Punonjësit e uzinës së përpunimit të naftës në Ballsh, po punojnë aktualisht me kushtë të pafavorshme pune dhe për më tepër janë në mëshirë të fatit për sa i përket sigurisë së punës.

Kjo padrejtësi që po u bëhet punonjësve në këtë uzinë, tashmë duhet të marrë fund. Të bashkuar do të bëjmë të mundur që e drejta e klasës punëtore të mos shpërfillet por të vlerësohet dhe të konsiderohet si një e drejtë e pamohueshme.

FSPISH do të jetë gjithmonë aty, ku dhe ka qenë, krah për krah me anëtarët e saj besnikë, duke luftuar bashkë me ta për te drejtat e tyre.

AKSIONET TONA



Qindra punonjës të Uzinës së Përpunimit të Naftës në Ballsh, kishin mëse një muaj që ishin të papunë dhe për mëse shumë muaj të tjerë që nuk u paguheshin sigurimet shoqërore dhe nuk kishin marrë pagat. Edhe pas shumë bisedimeve që FSPISH kishte bërë me pronarin e atëhershëm të uzinës, nuk kishin arritur asnjë marrëveshje, për t'iu paguar pagat dhe sigurimet shoqërore punonjësve të uzinës. Përveç bisedimeve me pronarin e kompanisë, problemi i naftëtarëve ishte ngritur deri në qeveri duke kërkuar kështu ndërhyrjen e qeverisë, pasi ashtu siç dhe dihet kjo uzinë është objekt i rëndësisë së veçantë dhe si e tillë duhet të trajtohet dhe nga qeveria. Por deri në Dhjetor të 2017s, asnjë rezultat. Atëherë e vetmja zgjidhje ishte protesta.

Më datë 21.12. 2017, punonjësit e uzinës së përpunimit të naftës, Ballsh, të udhëhequr nga FSPISH dhe Sindikata e Përpunimit të Naftës (pjesë përbërëse e FSPISH), protestuan para kësaj kompanie, duke bërë thirrje që nëse zëri i tyre nuk do të dëgjohej dhe djersa e tyre nuk do t'u jepet, atëherë do të përshkallëzojnë protestat e tyre në forma të ndryshme.

Federata Sindikaliste e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH), u bëri thirrje të gjithë drejtuesëve të kompanisë, që ajo do të jetë krah për krah me sindikalistët e saj deri në plotësimin e kërkesave të drejta dhe legjitime të tyre.





Pas protestës së 21 Dhjetorit 2017, asnjë gjë nuk u përmirësua dhe asnjë zgjidhje nuk u dha nga kompania për punonjësit. Atëherë të gjithë punonjësit të udhëhequr nga Sindikata e Përpunimit të Naftës (SPNSH), iu drejtuan Prefekturës së Fierit më datë 27 Dhjetor 2017.

Pas një dite proteste para Prefekturës, vendosën të mos e mbyllin me kaq, por të vazhdojnë për të protestuar para Ministrisë së Energjitikës dhe Kryeministrisë në Tiranë. Ato u nisën në këmbë që nga Fieri për të mbërritur në Tiranë, ku dhe do protestonin. Dhe kështu pasi përshkuan mbi 100 km në këmbë, qindra protestues, protestuan para Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës në Tiranë. Më datë 28.12.2017, punonjësit e Uzinës së Përpunimit të Naftës ia dolën tashmë të protestonin para Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për pagat e papaguara nga Kompania. Kjo protestë ishte vijim i protestës së 21 Dhjetorit, ku punonjësit protestuan para dyerve të Kompanisë, gjithashtu dhe e 27 Dhjetorit, ku ata protestuan para Prefekturës në Fier.

Nga Fieri ato janë nisur dhe kanë ardhur në këmbë deri në Tiranë, ku dhe protestuan para Ministrisë. Pas disa orëve protestë, Ministrat Gjijnuri dhe Ahmetaj, kanë thirrur në një takim urgjent, kreun e Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë Taf Koleci, Presidentin e Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë, Kol Nikollaj dhe Kryetarin e Sindikatës së Përpunimit të Naftës të Shqipërisë, Kamber Iliazi, përfaqësuesit e punonjësve.

Pas këtij takimi me dyer të mbyllura u ra dakort që punonjësve do t'u jepeshin pagat nga kompania, në ditën në vijim, pra ditën e Premte, më date 29 Dhjetor 2017. Menjëherë lajmi iu komunikua punonjësve, ku këto të fundit ishin mosbesues dhe nuk pranorin ta mbyllnin protestën pa u siguruar që pagat të hidheshin po në atë ditë.



Me këtë protestë u arrit të paktën që këta naftëtarë të mund të ktheheshin në familjet e tyre dhe të mund të festonin Vitin e Ri bashkë me familjet dhe të dashurit e tyre.

FSPISH siguron të gjithë punonjësit që do të jetë krah për krah me ta për të luftuar për djersën dhe të drejtat e tyre.

Megjithëse lufta për të drejtat e tyre sapo ka filluar...

REFUZOJ TË JEM I PAPUNË



petrol-is
Türkiye Petrol İmporta İşçileri Sendikası

10 January 2018
Istanbul/Turkey

Dear Colleague Taf Koleci,

We are aware of that you have been carrying out a massive struggle for the rights of the oil workers in Ballsh and Fier districts in Albania. We have to underline that such a struggle for the rights of the workers of Albania is very valuable.

We, as Petrol-İs Union, fully support your fight for the rights of the workers in the oil sector. The blatant attitude and behaviours against its own workers by the company managements can not be acceptable.

As Petrol-İs Union, we send our warm solidarity messages to you, your union and our friends in the oil sector.

In Solidarity

FSPISH e ngriti këtë çështje shumë serioze për qindra punonjës të uzinës së Përpunimit të Naftës në Ballsh, deri në organizatat sindikaliste botërore, ku dhe është e afiliuar prej shumë kohësh. Sindikata më e madhe në sektorin e naftës në Turqi, Petrol-is, solidarizohet me punonjësit e uzinës, në protestën për pagat e papaguara.

Z.Ahmet Kabaca, Sekretari i Përgjithshëm i Petrol-İs, shprehet se: "Keni mbështetjen e plotë tonën në luftën tuaj për të drejtat e punëtorëve në sektorin e naftës. Të tilla padrejtësi nuk mund të jenë të pranueshme kurrsesi për ne si Sindikata".



WORLD FEDERATION OF TRADE UNIONS

Class oriented - united - democratic - modern - independent - internationalist

Athinë, 09.05.2017

Shqipëri: Solidariteti i Federatës Botërore të Sindikatave (WFTU) me punonjësit e kompanisë "IONIAN REFINING AND TRADING COMPANY" SHA (IRTC) në Fier të Shqipërisë

Federata Botërore e Sindikatave, duke përfaqësuar 92 milionë anëtarë nga 126 shtete nga çdo cep i botës, shpreh solidaritetin e saj ndaj punonjësit e kompanisë "IONIAN REFINING AND TRADING COMPANY" SHA (IRTC) në Fier të Shqipërisë, të cilët kohët e fundit gjenden në demonstrime për rrogat që nuk i kanë marrë dhe për të drejtën e tyre për punë të qëndrueshme dhe me të drejtë.

Si Federatë Botërore e Sindikatave mbështetësimin kërkesat e punëtorëve dhe

Edhe nga të tjera Organizata Sindikale ndërkombetare, janë marrë letra solidariteti, ku shprehej qartë se na mbështesin në luftën tonë të përbashkët, për punonjësit e rafinerisë së naftës në Ballsh.

Një prej tyre është letra solidarizuese e mbështetëses sonë dhe njëkohësisht Federatës më të madhe Botërore WFTU, si dhe PAME Greqi.



Pas Dhjetorit të 2017s, kompania që operonte në Uzinën e Përpunimit të Naftës, Ballsh, falimentoj, duke lënë kështu qindra punonjës në mes të rrugës. Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH), e ngriti këtë problem shqetësues në qeveri, duke u bërë thirrje për të gjetur një zgjidhje sa më të mirë dhe pozitive për këta punonjës dhe fatin e kësaj uzine strategjike për ekonominë e vendit tonë.

Nga fillimi i vitit 2018, kjo uzinë i jepet një kompanie të quajtur "Byllis Energy", e cila ishte pjesë e një kompanie ndërkombëtare të quajtur "Tosk Energy". Pasi kjo kompani merr uzinën në përdorim, ajo nuk merr parashysh asnjë obligim që kishte për punonjësit. Biles la jashtë dyerëve të uzinës shumë punonjës të kualifikuar, të cilët kishin derdhur djersën e tyre në atë uzinë, duke i zëvendësuar me punonjës të rinj, të pakualifikuar. Tashmë lindi një nevojë tjetër, të mbrojmë punën dhe të rikthejmë të gjithë punonjësit në vendet e tyre të punës. Më datë 07.02.2018, Sekretari i përgjithshëm i FSPISH, bashkë me punonjës të Uzinës së përpunimit të naftës në Ballsh, aktualisht të papunë dhe me punonjësit e zjarrëfikseve të kësaj uzine, protestuan para uzinës. Zjarrëfikësit e Uzinës, aktualisht në punë me të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet si punonjës, por pa marrë asnjë rrogë nga punëdhënësi për shumë muaj me rradhë, kerkojnë të dinë se kush përgjigjet për t'iu paguar djersën e punës së tyre. Ndërsa punonjësit e papunë janë në pritje të vënies në punë të uzinës dhe rikthimit të tyre në punë. Ata kerkojnë nga qeveria shqiptare t'i jepet zgjidhje këtij problemi jetik për ta, por edhe kësaj "gangrene" që i është kanosur ekonomisë së vendit. FSPISH ka qënë, është dhe do të vazhdojë të jetë një mbështetës kyç për të luftuar për të drejtat e punonjësve. Ne s'e kemi besuar dhe s'do ta besojmë kurrë që s'ka naftë në Shqipëri, por keqmenaxhimi i saj e ka çuar në një rrugë pa krye. "Kjo nuk është as protesta e parë dhe as e fundit" - shprehet Sekretari i Përgjithshëm i FSPISH-s, zoti Taf Koleci.

REFUSE TO BE JOBLESS

REFUZOJ TË JEM I PAPUNË!



The struggle of Albanian workers is our struggle too



Së bashku t'i themi jo papunësisë. "REFUZOJ TË JEM I PAPUNË", ka qenë kryefjala e protestës para dyerve të mbyllura të Uzinës. FSPISH do të vazhdojë t'i mbështesë punonjësit deri në rikthimin e tyre në punë. Ishte pikërisht kjo tema solidaritetit ndërkombëtar të Ditës së Naftëtarëve Shqiptarë, e caktuar nga rrjeti ndërballkanik i RETUNSEE, nën sloganin: "REFUZOJ TË JEM I PAPUNË"

Më 12 Mars 2018, i gjithë rrjeti energjik RETUNSEE, u solidarizua me naftëtarët shqiptarë në luftën e tyre për punë. Në vendet respektive të tyre, kolegët e rrjetit ndërmorën aksione të ndryshme, për t'u solidarizuar me naftëtarët shqiptarë. Gjithashtu një poster i posaçëm iu caktua kësaj dite solidarizuese. FSPISH në këtë ditë ndërmori aksione të ndryshme, me mbledhje, deklarata për shtyp, gjithashtu dhe paralajmërim për vijimin e protestave, deri në plotësimin e kërkesave të drejta të naftëtarëve.





Në prill të 2018s, pas shumë kërkesave dhe protestave në dyert e kompanisë, u arrit nënshkrimi një akt-marrëveshjeje ndërmjet Administratorit të përgjithshëm të "Byllis Energji", Z. Blerim Hoxha dhe përfaqësuesve të punonjësve të uzinës, FSPISH, kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm Taf Koleci, Kryetari i SPNSHs Z. Kamber Iliazi, si dhe palë e tretë ishte ndërmjetës nga qeveria Këshilltari i Ministrisë Z. Ilir Bejtja. Në këtë akt-marrëveshje, ndër të tjerash u ra dakord nga palët që pas 6 muajve do të nënshkruhej kontrata kolektive e punës, që do t'i mbronte të gjithë punonjësit e kësaj uzine. Edhe pse tashmë ka kaluar më shumë se një vit nga afati për nënshkrimin e kontratës kolektive të punës ndërmjet kompanisë Byllis Energji dhe FSPISH, kjo gjë nuk ka ndodhur. Përkundrazi nga ana e drejtuesëve të kompanisë, ka patur reagime negative për anëtarët e FSPISHs, duke mos lejuar futjen e Kryetarëve të Sindikatës në ambjentet e uzinës dhe në zyrën e sindikatës që ndodhet brenda kësaj uzine, gjithashtu dhe me kërcënime me pushim nga puna për anëtarët e FSPISHs.

FSPISH është ankuar në instancat përkatëse të shtetit Shqiptar, për ta zgjidhur këtë dhe për të mundur sindikatën të futet në ambjentet e uzinës dhe për të arritur të bëjë misionin mbrojtës, por deri më tani fjala jonë ka shkuar në vesh të shurdhët.

Kjo çështje është trajtuar dhe me Organizatën Sindikale më të madhe Botërore dhe Europiane, siç është industriALL Europe dhe Global Union, të cilat i kanë dërguar një letër të përbashkët për lidhjen e kontratës kolektive të punës me FSPISHn, si Z. Blerim Hoxha drejtuesit të kompanisë, ashtu edhe Kryeministrit të Shqipërisë Z. Edi Rama.

IndustriALL Europe and Global Union, pasi kanë ndjekur të gjithë aksionet e ndërmarrja nga FSPISH dhe situatën e krijuar në uzinë, nga mosnjohja e Sindikatës nga ana e drejtuesëve aktual të uzinës, i ka bërë thirrje si qeverisë dhe drejtuesëve të kompanisë "Byllis energy", për t'a zgjidhur këtë problem kaq shqetësues për të gjithë punonjësit e uzinës, ashtu sikurse dhe përfaqësuesëve të tyre.



Brussels and Geneva, 15 January 2019

Mr. Blerim Hoxha
General Administrator
Byllis Energy
Rruga Emin Duraku, Pallati Billaket, Nr.5,
Tirana, Albania

By e-mail: blerimhoxha@tosk.ch

IndustriALL Global Union and industriAll European Trade Union urge Byllis Energy to resume negotiations and sign a collective agreement with FSPISH

Dear Mr Hoxha,

We are writing this letter to you on behalf of [IndustriALL Global Union](#) and [industriAll European Trade Union](#), both representing millions of workers in mining, energy and manufacturing industries in Europe and worldwide, including Albania, to urge Byllis Energy to resume negotiations and sign a collective agreement with FSPISH. Please note that the Trade Union Federation of Industrial Workers of Albania (FSPISH) is an active member of our organizations.

FSPISH has informed us that they have been seeking to reach a collective agreement with you as the General Administrator of Byllis Energy for some time. However, the process initiated in April 2018 with the signing of an Act-Agreement setting the framework for bargaining has stalled and there seems to be no willingness on your part to engage now in good faith negotiations and abide by the terms of that Agreement.

In addition, FSPISH has reported that you do not want to recognize them anymore as representative of the workers in the oil processing plant and you intend to set up another union in the company. Not only are workers harassed and put under pressure but they have also been threatened with dismissals if they remain with FSPISH.

Such behaviour on the part of Byllis Energy management is unacceptable and inconsistent with international labour standards. This is a clear violation of fundamental labor standards, including Convention 87 on Freedom of Association and Protection of the Right to Organize and Convention 98 on the Right to Organize and Collective Bargain of the International Labour Organization (ILO), which your country has ratified. Preventing union leaders from entering their office and performing their tasks is another serious breach of ILO standards.

We therefore urge you to rectify the situation without any delay, resume negotiations with our affiliate FSPISH and reach a collective agreement for the benefit of all - workers and the company alike.



DITA NDËRKOMBËTARE E GRUAS

FSPISH siguron, jo vetëm anëtarët femra të saj, por të gjithë gratë, se FSPISH do të jetë gjithmonë krah për krah tyre, për të pasur barazi gjinore dhe pjesëmarrje të lartë të grave kudo.

Federata Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë, është solidarizuar me Sindikatën Europiane EPSU, ku dhe është anëtare prej shumë vitesh, në fushatën për "Barazi gjinore dhe të drejta të barabarta".





SË BASHKU

PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË!







STATUSI MINATORIT

Minatorët me Status...

Kjo ishte kryefjala e thirrjeve të minatorëve para Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë më 15 Mars 2018. Ne nuk largohemi pa na dhënë përgjigje çfarë do bëhet me statusin e minatorit.

S'ka vonuar shumë dhe është kërkuar nga ana e qeverisë një takim, ndërmjet tyre dhe përfaqësues të FSPISH, Grupit të Interesit dhe përfaqësues të Sindikatës së Minierës Bulqizë. Një grup pune është caktuar me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, një përfaqësues nga Ministria Financave dhe Ekonomisë, me përfaqësues të Federatës të Punonjësve të Industrisë dhe përfaqësues të grupit të interesit, gjithashtu dhe të juristit të FSPISH, për të biseduar, rishikuar dhe vlerësuar projektstatusin e minatorit të Federatës Sindikaliste të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH), Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) dhe Grupit të Interesit.

Sekretari i Përgjithshëm i FSPISH është shprehur se nuk do ndalemi pa e arritur miratimin e statusit të minatorit, një e drejtë e vonuar pa arsye nga ana e qeverisë.



SË BASHKU

PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË!





FSPISH
#SIGURI #MBROJTJE #DINJITET





PROTESTA PARA KRYEMINISTRISË PËR STATUSIN E MINATORIT

Më datë 06.06.2018, para Kryeministrisë zhvillohet protesta e minatorëve, të cilët të kryesuar nga Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë (FSPISH) dhe nga Konfederata e Sindikatave (KSSH), janë ngritur pas një zvarritje që po i bëhej miratimit të " Statusit të miratorit" nga ana e qeverisë. Ish minatorët, me të drejtë kërkojnë një të drejtë legjitime, e cila duhej të ishte miratuar vite më parë, e jo siç po ndodh aktualisht, që po zgjatet e stërzgjatet pa arsye.

Projektligji për këtë status është dorëzuar në qeveri, dhe pasi u ngrit një grup pune, i përbërë nga specialistë të fushës në Ministrinë përkatëse, Presidenti i KSSH-s, Sekretari i Përgjithshëm i FSPISH-s si dhe Grupi i Interesit (ish minatore), ku ky grup u kryesua dhe u drejtua nga Z. Mehmet Hasalamaj , përfaqësues i Ministrisë, ku gjithçka u zhvillua me sukses, nuk ka arsye të mëtejshme për zvarritjen e kalimit dhe miratimit të tij në qeveri.

Kjo nuk është protesta e pare, por FSPISH deklaroi që s'do të jetë as e fundit deri sa të miratohet Statusi i Minatorit.

Ky status është një e drejtë e fituar me gjakun dhe djersën e këtyre minatorëve, të cilët e kanë ngritur këtë shtet për 50 vjet. Sot ato jetojnë në kushte skandaloze, s'kanë para as për ilaçe, duke ditur që shumica e tyre vuajnë nga semundje të rënda profesionale. FSPISH dhe KSSH i bënë me dije Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe gjithë politikanëve Shqiptarë, që kauza e tyre është një kauzë jetike dhe që ne do të luftojmë për krah bashkë me to për të fituar këtë të drejtë aq sa jetike por dhe legjitime.

Sekretari i Përgjithshëm i FSPISH-s Taf Koleci, në mbledhjen me ish minatorët, që u zhvillua fill pas protestës u garantoi atyre, ashtu si gjithmonë, mbështetje të pakufishme për këte kauzë, ashtu siç ka bërë që nga iniciimi i saj. " Do të vazhdojmë me protesta të tjera, duke parë që nga ana e Qeverisë nuk po bëhet asgjë, e jo vetëm, por dhe greva të ndryshme, deri në miratimin e " Statusit të Minatorit"- thekson Sekretari Përgjithshëm i FSPISHs, Taf Koleci. Ne jemi të bindur, më shumë se kurrë, se vetëm të bashkuar, solidar dhe këmbëngulës do t'ia arrijmë qëllimit tonë.



Taf Koleci: Ligji sjell mbështetje financiare për naftëtarët, minatorët e metalurgët

Udhëzimi i ri për naftëtarët dhe minatorët kreu i federatës së sindikatave zbardhet: Ja benefitet që do të sjellin

Merita e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë ka përfunduar një ligj, i cili do të sjellë me shumë shpresë për minatorët, naftëtarët dhe metalurgët. Duke qenë se kjo kategori është e probleme, është menduar që të dihet më së miri. Presidenti i Federatës së Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë, Taf Koleci, ka rregulluar në ditët e fundit të kësaj ligji. Ligji sjell benefitet që do të sjellin për minatorët, naftëtarët dhe metalurgët. Ligji sjell benefitet financiare si për minatorët, ashtu dhe për metalurgët.

si se do të përfillojë çdo minator, metalurg dhe naftëtar, të cilët nuk duhet ta çojnë ruajtjen e tyre për duhet ta çojnë ligj mbi përfundim të pensionit. Dhe unë do t'u kujtoj disa nene të projektligjit që jemi duke bërë. Në takon trajtimin financiar të punonjësit të minierave që kanë punuar nën tokë, të punonjësit të industrisë së naftës dhe të tokës, të punonjësit të industrisë së metalurgjisë. Unë po citoj disa nene që ka ky projektligj, i cili vendos trajtimin financiar suplementar për profesionet e vështira të vështira të minatorëve e minatorëve, naftëtarëve dhe metalurgëve. Projektligji është dhe flet për trajtimin financiar gjegjë, që lidhet jo vetëm me përfitimet financiare në moshë pensionare.

Pse janë përfshirë në një ligj 3 profesione dhe çfarë rishik ka? Përfshirja në një ligj i tre profesioneve të vështira, është bërë për shkak të ngjashmërisë dhe lidhjeve të vështirësive në punë brenda kësaj parrmi. Ka janë bërë dallime në punë të vështira dhe shpreh të vështira. Nuk është ruajtja e punës që një ligj hartohet për disa kategori të ndryshme punës, por edhe karakteristika të ngjashme dhe që adresojnë problematika të njëjta. Ky projektligj u jep pension para kohës deri në dhjetë vjet para moshës normale të daljes në pension, pra kjo do të thotë që nga 63 vjeç, të shkojë 55 vjeç, ose nga 55 vjeç në 45 vjeç. Po ashtu, ky projektligj u jep moshën normale të daljes në pension për të gjithë pensionistët aktualë dhe ata që do të dalin në periudhën afat shkurtër. Kjo shtesë në pension nuk është e financuar nga kontributet e paguara por është një ligj dhe një privilegj i pastër që ju bëhet këtyre kategorive të financuara nga buxheti i shtetit. Në këtë shtesë të ardhur e shumicës së minatorëve arrijnë një pension maksimal që përfitojnë nga pensioni, pensionistët e tjerë.

Në ligjin aktual është ulur dalja e moshës në pension. Qeveria 'Berisha' e çoi në 60, ndërsa qeveria 'Rama' e ka çuar në 55. Ky projektligj sjell një shtesë të pensionit për të gjithë ata që kanë punuar në këto profesione të vështira. Në ligjin aktual është ulur dalja e moshës në pension. Qeveria 'Berisha' e çoi në 60, ndërsa qeveria 'Rama' e ka çuar në 55. Ky projektligj sjell një shtesë të pensionit për të gjithë ata që kanë punuar në këto profesione të vështira.

gjë që kemi hartuar ju? Naftëtarët kanë shumë shtesë bërë një ligj të ri, Zyrat, por për këtë ligj është një shtesë të pensionit.



SË BASHKU

PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË!



Unë do t'u kujtoja disa nene të projektligjit që jemi duke bërë në takon trajtimin financiar të punonjësit të minierave që kanë punuar nën tokë, të punonjësit të industrisë së naftës.

Unë do t'u kujtoja disa nene të projektligjit që jemi duke bërë në takon trajtimin financiar të punonjësit të minierave që kanë punuar nën tokë, të punonjësit të industrisë së naftës.



FSPISH

#SIGURI #MBROJTJE #DINJITET





TRAJNIME TË SINDIKALISTEVE TË FSPISH NË ANKARA -TURQI

Çdo vit, sindikalistë të ndryshëm, anëtarë të FSPISHs, trajnohen në fushën e sindikalizmit dhe tematikave të ndryshme që lidhen me të.

Grupe sindikalistësh marrin leksione nga lektorë të ndryshëm, si jurisë apo ekonomistë, çështje që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe shkëmbejnë eksperiencën të ndryshme për sa i përket çështjeve sindikaliste.

Ato njihen më nga afër me strukturën e sindikatave turke dhe eksperiencat e tyre në mbrojtje të klasës punëtore. Deri më tani janë dërguar grupe, minimalisht me nga 25 sindikalistë për trajnim në Ankara, Turqi.

Bashkëpunimi ynë sindikal me sindikatën e Turk Metal, sindikatën më dinjitoze në mbrojtjen e punonjësve të metalurgjisë në Turqi dhe anëtarësimi ynë në IEMF, ka bërë të mundur që sindikalistët tanë të trajnohen në një aspekt global, duke mundur ta integrojnë atë në një kuadër kombëtar.

Eksperiencat e fituara në këto trajnime, janë shumë të dobishme dhe frutdhënëse në misionin sindikalist në mbrojtje të të drejtave të punonjësve.

Sindikalistët në fund të trajnimit marrin një certifikatë njohëse për trajnimin e bërë, e cila iu jepet nga Sekretari Përgjithshëm I IEMF dhe drejtues të sindikatës TURK METAL.



BASHKËPUNIMET TONA

FSPISH është anëtare e denjë e shumë organizmave sindikale ndërkombëtare. Anëtarësimin në këto organizata sindikale Europiane dhe Ndërkombëtare e sheh si një gjë shumë të rëndësishme, e cila e çon përpara lëvizjen sindikale në Shqipëri. Punonjësit shqiptarë përfaqësohen denjësisht në një atmosferë globale për të ngritur çështje të ndryshme për sa i takon mbrojtjes së të drejtave, kushte sa më të mira dhe të sigurt pune, paga dhe pensione dinjitoze për një jetë sa më të mirë të të gjithë shqiptarëve.

Shumë aktivitete të ndryshme sindikale kanë qënë çelësi i suksesit dhe i aftësisht në fushën sindikaliste. Të rinjtë sindikalistë të FSPISHs, trajnohen në fusha të ndryshme si ajo e legjislacioneve të punës, në fushën e sindikalizmit dhe në shumë çështje të tjera të lidhura me sindikalizmin dhe tematikat specifike të tij, për një sindikalizëm sa më të fortë në Shqipëri. FSPISH ndjehet krenare për këtë bashkëpunim korrekt dhe shumë frytdhënës me sindikatat ndërkombëtare.



Sindikata industriALL Europe

Sindikata industriALL Europe, është një sindikatë Europiane e cila operon në fushën e industri - minierave. Kjo sindikatë përfaqëson punonjësit në Europë në fushën e industrisë si miniera, energji, metalurgji, fasoneri etj. FSPISH është krenare që është pjesë e industriALL Europë dhe njëkohësisht që mbështetet prej saj.

Sindikata industriALL Global

IndustriALL Global Union është një organizatë sindikaliste Botërore. FSPISH është anëtare e industriALL Global Union, ku numëron një sërë aktivitete dhe aksione të përbashkëta. Kjo Sindikatë Globale përfaqëson punonjësit në të gjithë botën në fushën e industri- minierave.



EPSU DHE PSI

Sindikata e Shërbimeve Publike Europiane (EPSU) dhe Shërbimet Publike Ndërkombëtare janë sindikata që operojnë në fushën e shërbimeve publike siç janë: energjia, ujësjellës- kanalizime, shëndetësia, arsimi etj. Epsu dhe PSI janë forca dhe zëri i mijërave punonjësve të shërbimeve publike në të gjithë botën. FSPISH është anëtare e denjë e tyre prej shumë vitesh.



Federata Ndërkombëtare e Punonjësve të Metalurgjisë së Euroazisë (IEMF)

IEMF është një Federatë Sindikale në sektorin Metalurgjik. Ajo ka mbledhur rreth vetes sindikata që operojnë në këtë sektor në rajonin Euro-Aziatik. FSPISH është pjesë e IEMF që prej disa vitesh dhe anëtarësimi ynë në IEMF ka qenë shumë domethënës dhe i suksesshëm në misionin tonë, në mbrojtje të të drejtave të punonjësve. FSPISH është krenare për këtë bashkëpunim shumë korrekt dhe domethënës, i cili është gjithmonë në fuksion të sindikalizmit në një kuadër të gjerë Global.



Sindikata Turk Metal

Një bashkëpunim të suksesshëm dhe shumë të fuqishëm FSPISH e ka me sindikatën "Turk Metal" që operon në sektorin e metalurgjisë në Turqi. Kjo Sindikatë ka qënë si një busull me suksesin e saj të padiskutueshëm për sa i takon mbrojtjes së të drejtave të punonjësve. Shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave të mira, kanë bërë që FSPISH të jetë gjithmonë sa më dinjitoze në mbrojtjen e anëtarëve të saj. Kjo sindikatë përfaqëson zërin e punonjësve të sektorit metalurgjik në Turqi.



Federata Sindikale Botërore (WFTU)

Një bashkëpunim të rëndësishëm dhe shumë solidaritar FSPISH e ka me Federatën Sindikale Botërore (WFTU), e cila përfaqëson zërin e 92 milion anëtarëve rreth e qark botës. Bashkimi dhe solidariteti sindikal botëror ka bërë që ne të mos ndjehemi kurrë vetëm në luftën tonë në mbrojtje të klasës punëtore.



RETUNSEE

RETUNSEE është një organizatë ndër-ballkanike që ka mbledhur rreth vetes së saj sindikata nga i gjithë rajoni Ballkanit në sektorin energjik. FSPISH është anëtare e RETUNSEE që prej disa vitesh, ku numëron një sërë aktiviteteve dhe aksionesh të përbashkëta në aftësimin sindikal.



TUI Energy

Sindikata botërore e Energjisë (TUI Energy) ka bashkuar së fundmi, sindikata nga e gjithë bota në sektorin energjik si: miniera, energjia, nafta dhe gazi, kimi-metalurgjia etj. Kjo organizatë Sindikale synon në mbrojtjen e interesave të punonjësve në sektorin Energjik. Globalizimi ka sjellë si një nevojë të domosdoshme dhe globalizimin sindikal, duke synuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punonjësve në kompani të ndryshme multinacionale.

Gjithashtu FSPISH ka bashkëpunime shumë të suksesshme bilaterale me shumë sindikata të tjera të rajonit Ballkanik, Europiane apo dhe Botërore. Së fundmi ka nënshkruar një protokoll bashkëpunimi me Federatën Arabe të Punonjësve të Minierave, Kimisë dhe Naftës. Ky protokoll bashkëpunimi u kurorëzua dhe nga Konsullja e Egjiptit në Tiranë Znj. Inas Faissal. FSPISH është e hapur për bashkëpunime të reja, pasi vetëm të bashkuar rreth kauzës sonë të përbashkët, jemi më të fortë dhe më të suksesshëm. Së bashku për një të ardhme të sigurtë për klasën tonë punëtore!

FSPISH 2019



FSPISH 2019

"SINDIKATA JENI JU, KLASA PUNËTORE
SHQIPTARE"

TAF KOLECI



